



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. ____ Prot.

Patos, më 26/09/2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje mjeti traktor dhe frezë për pastrimin e
kanaleve kulluese në territorin e Bashkisë Patos**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

KODI CPV: Traktorë 16700000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile për vitin 2025, për objektin: **“Blerje mjeti traktor dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese në territorin e Bashkisë Patos”**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se fondi limit i procedurës objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

12.000.000 (dymbëdhjetë milion) lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2025.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$12.000.000 \times 20\% = 2.400.000$ (dy milion e katërqind mijë) Lekë.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin një vetëdeklarim nëpërmjet të cilës marrin përsipër që "Garancia për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve të mundshme do të jetë 1 (një) vitë nga data e marrjes së mjetit në dorëzim, (përfshihen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit)".

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetëdeklarim kërkohej për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkt (mjet) funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.3. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetëdeklarojnë se nëse shpallen fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të Bashkisë Patos.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe kalimin e pronësisë pa patur kosto shtesë për AK-në pasi ky i fundit nuk ka parashikuar kosto të tjera.

2.3.4. Për mjetin duhet të paraqiten fotografi të qarta nga të gjitha anët dhe origjinale.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të pikës 6/b të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetëdeklarim kërkohej për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.5. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetëdeklarojnë vendndodhjen e mjetit (adresën e saktë) si dhe të dhënat përkatëse të mjetit me qëllim që Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos të bëjë verifikimin fizik të gjendjes teknike dhe vizuale të mjetit përpara shpalljes së ofertës fituese për operatorët ekonomik të kualifikuar sipas renditjes. Përben kusht për skualifikim nëse nga verifikimi vërehet se kemi mospërputhje të mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetëdeklarim kërkohej

për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkt (mjet) funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.6 Njëkohësisht operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi për mjetin që do të ofertojnë duhet të paraqesin dhe të ngarkojnë në sistemin e prokurimit skeden teknike me të dhënat përkatëse të Automjetit shoqëruar me dokumentacionin përkatës të mjetit si, Foto, Siguracion, Certifikatë pronësie, Certifikatën e Kontrollit teknik të mjetit.

ARGUMENTIM: Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 6/c dhe pika 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetdeklarim kërkohej për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale (mjetin) dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Specifikimet për mjetin

Specifikimet për ‘Blerje mjeti traktor dhe frezë për pastrimin e kanaleve kulluese në territorin e Bashkisë Patos’

Viti i prodhimit: Nuk do të pranohet asnjë mjet i cili është prodhuar para vitit 2024

Tipi i mjetit: Traktor

Kilometra të përshkruara: Mjeti duhet të ketë 0 (zero) orë pune. (Mjeti do të nënshtrohet kontrollit të vecantë nëse orët e punës janë manipuluar).

Dokumentacioni i kërkuar: Mjeti të jetë i pajisur me:

- Lejë qarkullimi shqiptare
- Targa Shqiptare
- Siguracion
- Të ketë kryer kontrollin teknik me cilësinë “kalon”.

Cilësitë e kërkuara të mjetit

Ngjyra: Nuk ka përcaktim.

Dyert: 2 (dy)

Pasqyrat: Mjeti duhet të jetë pajisur me setin e pasqyrave funksionale të cilat nuk duhet të kenë thyerje, gërvishtje apo dëmtime.

Xhamat: Xhamat nuk duhet të kenë krisje, thyerje apo demtime.

Çelsat: Mjeti duhet të jetë i pajisur me 2 (dy) Çelsa origjinale.

Numri i ndenjësve: Mjeti duhet të ketë të paktën 1(një) ndenjësë

Ndënjësja e shoferit: rregullimi i saj me ajër ose manualisht

Lloji i karburantit: Diesel (Naftë) 10PPM

BHP Kuaj Fuqi: Mjeti duhet të ketë kuaj fuqi midis intervalit 95 – 105 kuaj fuqi (kjo është e barabartë me 70.84 kw – 78.29kw).

Kutia e shpejtësisë: Manuale ose automtike

I pajisur me kovë të përparëme me kapacitet mbajtës minimalisht 0.30m³

Emëtimi gazrave: Nuk do të pranohet asnjë mjet i cili e ka emëtimin e gazrave më pak se Euro 4.

Konsumi: I kombinuar

Gomat dhe disqet: Mjeti duhet të jetë i pajisur me një set gomash 100% të reja. Disqet duhet të jenë aliazh metal.

Historia e aksidenteve: Mjeti duhet të jetë “accident free” i pa aksidentuar pra nuk duhet të ketë një histori aksidenti, për këtë kriter mjeti do të ushtrohet një kontrolli të vecantë nga një komision i ngritur pranë Bashkisë Patos.

Shasia: Mjeti nuk duhet të ketë ndryshk, zevëndësime apo prerje të trupit të cilat mund të jetë salduar apo modifikuar për të sjellë në gjendjen e mëparëshme.

Pamja vizuale: Mjeti nuk duhet të ketë gërvishtje, shtypje ose deformime.

Sistemi operativ softwerik: Sistemi operativ i mjetit duhet të jetë 100% funksional, nuk duhet të ketë ndërhyrje softwerike ose kodime softwerike nga persona ose oficina jo të autorizuar nga prodhuesi i mjetit si në sistemin qëndror ashtu dhe në paketa të vecanta si kambio, transmission ose sistemin e drejtimit. (Për këtë mjet do të nënshtrohet një kontrolli të imtësishëm me pajisje të vecanta për të treguar në cdo ndërhyrje softwerike që mund të jetë bërë mjetit).

Pjesët gjenerike dhe mekanike: Të gjitha pjesët gjenerike dhe mekanike duhet të jenë të reja në masën 100%.

Pajisjet digitale: Pajisjet digitale, si paketa, dhe sistemet elektronike, duhet të jenë 100% funksionale dhe nuk do të pranohet asnjë mjet paketat e te cilit janë të ndërruara, jo origjinale ose të përdorura dhe të koduara nga persona apo oficina jo të licensuara nga kompania prodhuese e mjetit.

Sistemi i frenimit:

ABS	E përfshirë
-----	-------------

Interiori

Kroskot	✓
Ore digjitale ose Mekanike	✓
Ekrani i temperaturës	✓
Sedilje të rregullueshme	Manuale ose automatike

Cilësitë e interiorit dhe argëtimit

Sistem kondicioner: PO

Kompjuter në bord: PO

Lubrifikim qëndror: PO

Kuti e veglave: PO

Drita gabarite: PO

Garacia për mjetin e ofertua 1 (një) vitë

Frezë për pastrimin e kanaleve kulluese

Viti i prodhimit: 2025

Pesha: 450 - 480 kg

Kërkesa e energjisë: 44 kW

Përmasat: 185cm – 210cm

Manovrimi: Freza duhet të jetë e pajisur me mekanizëm i cili të lejon uljen, ngritjet, majtas djathtas, Diagonale nga ana e majtë, Diagonale nga ana e djathtë

E pajisur me krahë të gjatë për manovrim sa më të lehtë.

E pajisur me sistem hidraulik për kapjen tek traktori.

E pajisur me kutinë e shpejtësisë për nivele të ndryshme të shpejtësisë.

Garancia 1 (një) vitë

Turriellë për hapjen e gropave hidraulike

Garanca	1 Year.
Komponentët kryesorë	Kutia e shpejtësisë, motori
lloj	Implemetimi në traktor
Përdorimi	Gërmimi
Pesha bruto	70kg-200kg
Përmasat e tehut	230mm, 300mm, 500mm

Karakteristikat

Boshti i lëvizjes PTO i mbrojtur për punë të rëndë, për të mbrojtur pajisjet nga goditja e papritur e rrënjëve dhe shkëmbinjve.

Kapja e Bulonave me madhësi të ndryshme (6", 9", 12", 18", 24")

Specifikimet teknike të Hartuara janë bazuar në nevojat e Autoritetit Kontraktor bazuar në pikën 2 neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar për të patur një Automjet cilësor e të përshtatshëm për funksionalitetin e veprimtarive që zhvillohen.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **14/10/2025, ora 09:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje autobot uji"

Bashkëlidhur këtij procesverballi:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT

Shkëlqim Xhaferi

Florian Kita

Ermenita Mici